

# KATALOGU I PROVIMIT

VITI SHKOLLOR 2020/2021

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

PROVIMI I MATURËS DHE PROVIMI PROFESIONAL NË SHKOLLAT E MESME KATËRVJEÇARE





## **KATALOGUN E PROVIMIT E PËRGATITEN:**

**VALBONA HOXHIQ**

SHF „M. Tito”, Ulqin

**DR. RROK GJOLAJ**

Ministria e Arsimit të MZ

**MR. SEHAD LULANAJ**

SHMP „25 Maji”, Tuz

**ISLAM HOTI**

SHMP „V. Bashkimi”, Ulqin

**LUIGJ BERISHA**

Qendra e Provimeve, Podgoricë



## **PËRMBAJTJA**

**1. HYRJE 4**

**2. RREGULLAT 5**

**3. QËLLIMET E PËRGJITHSHME 6**

**4. STRUKTURA I PROVIMIT 7**

**5. PËRMBAJTJA E PROVIMIT DHE QËLLIMET 9**

**5.1. Gjuhë 9**

**5.2. Letërsi 10**

**5.3. Të shprehurit me shkrim 12**

**5.4. Veprat letrare të detyrueshme 13**

**6. SHEMBULLI I TESTIT 14**

**7. FLETA E PËRGJIGJEVE 25**

**8. ZGJIDHJA E TESTIT ME SKEMË PËR VLERËSIM 26**

**9. LITERATURA 33**

# 1

## HYRJJE

Provimi i Maturës dhe Provimi Profesional paraqesin kontrollimin ekstern të standardizuar të arriturave të standardeve të domosdoshme të njohurive në fund të arsimimit të mesëm katërvjeçar.

Në bazë të Ligjit për gjimnazin dhe Ligjit për arsimin profesional („Gazeta Zyrtare e RMZ“, nr.64/02, 49/07 dhe „Gazeta Zyrtare e MZ“, nr. 45/10, 39/13 dhe 47/17), Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kohën e dhënies së Provimit të Maturës në gjimnaz („Gazeta Zyrtare e MZ“, 34/09, 19/10, 81/10, 60/11, 65/12, 50/13 dhe 43/19) dhe Rregullores për mënyrën dhe procedurën e dhënies së Provimit Profesional për nxënësit të cilët vazhdojnë arsimimin („Gazeta Zyrtare e MZ“, nr. 82/09, 19/10, 81/10, 60/11, 65/12, 58/13 dhe 43/19) Provimi i Maturës dhe Provimi Profesional jepet në mënyrë ekstere. Punët profesionale, zhvillimore, organizative dhe administrative, lidhur me realizimin e këtyre provimeve do t’i bëjë Qendra e Provimeve.

Nga viti shkollor 2020/21 nxënësit e gjimnazit të përgjithshëm<sup>1</sup> dhe shkollës profesionale 2 në fund të vitit të katërt e japin provimin duke zgjidhur të njëjtin test. Për këtë arsye Katalogu i provimit është rezultat i programeve të lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe për gjimnazin e përgjithshëm dhe shkollën profesionale.

Kontrollohen njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë të cilat bazohen në pjesët kryesore të Programit të Lëndës dhe duhet t’i posedojnë nxënësit në fund të vitit të katërt të gjimnazit dhe shkollës profesionale.

Në katalogun e provimit janë dhënë qëllimet e përgjithshme të provimit, programi i provimit me fushat dhe qëllimet, shembulli i testit me skemën e vlerësimit dhe literatura.

Katalogu i provimit u kushtohet nxënësve dhe mësimeve të tyre.

<sup>1</sup>Programi i lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi klasa I, II, III, IV e gjimnazit të përgjithshëm, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Enti për Shkollim, Podgoricë, 2016.

<sup>2</sup> Programi i lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi klasa I, II, III, IV e shkollës së mesme profesionale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Enti për shkollim, Podgoricë, 2017.

Provimi nga Gjuha shqipe dhe letërsia do të mbahet në kushte të njëjta dhe në mënyrë të njëjtë për të gjithë nxënësit e vitit të katërt.

Materiali i provimit do të pakëtohet në qese të sigurta (PVC dhe u dërgohet shkollave në ditën e provimit. Hapja e materialit bëhet para nxënësve para fillimit të provimit.

Në provim nuk lejohet

- prezantimi rrejshëm
- shfletimi dhe shikimi i detyrave të provimit para kohës së lejuar
- pengimi i nxënësve tjerë
- përshkrimi nga nxënësi/nxënësja tjetër
- krijimi i mundësisë për nxënësin/nxënësen tjetër që të përshkruajë
- përdorimi i mjeteve të palejuara
- përdorimi i mjeteve elektronike
- dëmtimi i shifrës në librezën e testit
- mosrespektimi i sinjalit për përfundimin e provimit

**Mjetet e lejuara:** lapsi i thjeshtë, goma dhe lapsi kimik/stilolapsi.

Punimi i nxënësit **duhet** të jetë i shkruar me laps kimik/stilolaps.

Detyra do të vlerësohet **me zero pikë:**

→ nëse përgjigjja është e pasaktë

→ nëse përgjigjja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë NUK është kaluar në fletën e përgjigjeve

→ nëse është rrethuar ose është shkruar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

→ nëse përgjigjja/eseja është shkruar e palexueshme

→ nëse përgjigjja/eseja është shkruar me lapsin grafit

→ nëse eseja **NUK** është shkruar në vendin e paraparë për te, por në fletët e parapara për koncept (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Pas provimit, testet do të pakëtohen dhe do të kthehen në Qendrën e Provimeve, ku do të organizohet vlerësimi i tyre.

# 2.

## RREGULLAT

# 3

## QËLLIMET E PËRGJITHSHME

**Pas përfundimit të vitit të katërt të shkollës së mesme, nxënësi do të mund:**

- të përdor parimet dhe normën e gjuhës standarde në të shkruar;
- të lexojë, kuptojë, zbërthejë, të vlerësojë në mënyrë analitike dhe kritike tekstet e ndryshme joartistike dhe artistike;
- të kuptojë rrjedhat themelore historike letrare dhe zhvillimin e formave të zhanrit;
- të kuptojë, interpretojë dhe të vlerësojë tekstet letrare;
- të vërej dhe vlerësojë vlerat estetike, etike dhe njohëse në veprën letrare;
- të tregojë njohuri funksionale nga teoria dhe historia e letërsisë;
- të përdor në mënyrë adekuate stilet funksionale me rastin e të shkruarit;
- të krijoj tekste të shkruara me stil dhe gjuhësisht të sakta.



#### 4.1. SKEMA E PROVIMIT (PROVIMI ZGJAT 180 MINUTA; TESTI PUNOHET PA PUSHIM)

FUSHAT	KOHËZGJATJA E PROVIMIT	PJESËMARRJA NË TEST	LLOJI I DETYRAVE	SHTOJCAT	
1	GJUHË	30'	nga 30% deri në 35%	Me zgjedhje të shumëfishtë, përgjigjja e shkurtër, me zgjedhje alternative, detyrat të cilat lidhen	Teksti përcjellës joartistik
2	LETËRSI	40'	nga 30% deri në 35%	Me zgjedhje të shumëfishtë, përgjigjja e shkurtër, me zgjedhje alternative, detyrat me radhitje	Teksti përcjellës letraro-artistik
3	TË SHPREHURIT ME SHKRIM	1. eseja – nga 80 deri në 90'  dhe 2. teksti funksional – nga 20 deri në 30'	nga 30% deri në 40%	1. shkrimi i hartimit (250 – 300 fjalë) dhe 2. shkrimi i tekstit funksional (lutja, ankesa, letra zyrtare/ jozyrtare, fletëfalënderimi, urimi, shpallja, reklama, konkursi, raporti, lajmi, intervista, reportazhi, rezymeja, përkujtuesi, debati, fletëparaqitja (për punë, në konkurs...), e-maili...)	Teksti përcjellës letraro-artistik dhe/ose joartistik
Gjithsej 180'					

# 4. STRUKTURA I PROVIMIT

# 4

## STRUKTURA I PROVIMIT

### PËRMES DETYRAVE/PYETJEVE NGA GJUHA DHE LETËRSIA NXËNËSI DUHET TË TREGOJË SE:

- e kupton përmbajtjen dhe dedikimin e tekstit joartistik/ përmbajtjen dhe domethënien e tekstit artistik
- i njeh dhe i përdor termet letraro-historike dhe letraro-teorike
- di të analizojë tekstin (një pjesë ose një fjali të tij).

### ME SHKRIMIN E EESË DHE TEKSTIT FUNKSIONAL NXËNËSI DUHET TË TREGOJË SE:

- e kupton temën
- di që në bazë të udhëzimeve të dhëna të shkruajë hartimin që ka një lidhshmëri dhe që është i qartë
- di të shpjegojë përjetimet e veta /të argumentojë pohimet e veta
- di të zbatojë rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore.



## A) KA TË BËJË ME PJESËN I TË PROVIMIT

*Nxënësi duhet të përgjigjet në pyetje lidhur me tekstet e lexuara joartistike dhe artistike: që e kupton tekstin, gjen informacione, i interpreton ato, i bashkon dhe i vlerëson.*

### 5.1. GJUHË

#### **NXËNËSI/NXËNËSJA DUHET TË DIJË:**

- çfarë është gjuha dhe cilat janë vetitë e saja dhe funksioni
- llojet e shkrimit
- të njohë familjen e gjuhëve indoevropiane
- të njohë zhvillimin e alfabetit të gjuhës shqipe nga fillimi e deri tek gjendja bashkëkohore e gjuhës shqipe
- të shpjegojë shtresat e gjuhës (zhargonet dhe sociolektet, përdorimin dhe kuptimin e tyre)
- të njohë, të dallojë, të interpretojë dhe të zbatojë ndryshimet fonetike dhe përjashtimet
- llojet e fjalëve dhe veçoritë e tyre morfologjike
- të dallojë llojet e fjalive dhe të sqarojë funksionin e tyre në tekst
- të shpjegojë vlerën kuptimore e kumtesore dhe stilistike të fjalisë
- foljen: kohët, mënyrat, vetat, zgjedhimet, formën veprare dhe joveprare
- të zbatojë rregullat e kongruencës (përputhshmërisë)
- të përdor drejt sistemin e rasave në të folur dhe në të shkruar
- të ketë njohuri bazë nga leksikologjia dhe të zotërojë me leksikun e gjuhës shqipe (sinoniminë, antoniminë, homoniminë, poliseminë)
- të dallojë llojin dhe karakterin e tekstit në bazë të leksikut
- të dallojë frazeologjizmat, termet, kalket, klishetë
- të njohë drejtshkrimin e gjuhës shqipe (shkrimin e shkronjës së madhe, shkrimin e shkurtesave, të zbatojë rregullat për shkurtimin e fjalëve dhe shprehjeve, të zbatojë rregullat për shkrimin e fjalëve bashkë dhe ndaras, të ndajë fjalët në fund të rreshtit, përdorimin e shenjave të pikësimit, t'i shqipërojë drejtë fjalët të cilat kanë një përdorim të shpeshtë.

## 5.2 LETËRSI

### NXËNËSI/NXËNËSJA DUHET:

- të kuptojë konceptin e motivacionit në ndërtimin e personazhit letrar
- të dallojë kompozicionin si një skemë të tekstit të strukturuar
- të vërej funksionet dhe rëndësinë e kornizës së tekstit letrar
- të dallojë kontekstin kulturor në tekstin letraro-artistik
- që në shembullin e tekstit të caktuar të dijë gjinitë letrare, zhanret dhe llojet dhe të dallojë kryqëzimet e zhanreve
- të dallojë veprat dhe autorët e periudhave letraro-historike nga antika deri te periudha bashkëkohore, të njohë veçoritë stilistike të epokave dhe drejtimeve
- të krahasojë specifikat e tyre stilistike
- të njohë veçoritë e gjuhës poetike dhe të kuptojë funksionin e saj estetik
- të vërej funksionet e subjektit lirik (rrëfimin e mendimeve, emocioneve, disponimit dhe asocimeve)
- të dallojë tipin asociativ të motivimit
- të dallojë dhe të formulojë temën dhe motivet e tekstit; të shpjegojë domethënien e tekstit të cituar
- të dallojë figurat stilistike (epitetin, krahasimin, personifikimin, hiperbolën, gradacionin, metaforën, metoniminë, antitezën/kontrastin, onomatopenë, asonancën, aliteracionin, anaforën, epiforën, alegorinë, polisindetin, ironinë, oksimoron, simbolin dhe funksionin e tyre
- të dijë elementet e vargëzimit dhe kufijtë konstruktiv të poezisë lirike (strofën: dyvargëshin (distikun), treshin (tercinën), katërvargëshin (katrenin), pesëvargëshin (pentestikun), gjashtëvargëshin (sektinën), shtatëvargëshin (septimën), tetëvargëshin (oktavën), nëntëvargëshin (nonën) dhe dhjetëvargëshin (decima); vargun: katërrokëshin, pesërrokëshin, gjashtërokëshin, shtatërrokëshin, tetërrokëshin, nëntërrokëshin, dhjetërrokëshin, njëmbëdhjetërrokëshin, dymbëdhjetërrokëshin, trembëdhjetërrokëshin, katërmëdhjetërrokëshin, gjashtëmbëdhjetërrokëshin, vargun e bardhë, vargun e lirë, vargun e thyer, vargun popullor, vargun e huazuar; rrokjen, theksin, cezurën, rimën, formën e sonetit)
- të njohë elementet e tekstit narrativ: narratorin, personazhet dhe tipat e karakterizimit, fabulën dhe syzheun, kronotopin, motivimin, këndvështrimin, ambientin
- të vërej funksionet e personazhit kryesor, dytësor dhe episodik
- të dallojë motivimin e shkakut dhe pasojës të tekstit narrativ

- të vërej mekanizmat motivues të cilët vënë në lëvizje personazhin: social, psikologjik, fantastik, artistik
- të dallojë teknikat epike: përsëritjen, retardimin, retrospektivën
- të dallojë format e rrëfimit dhe tipat e narratorit (forma Ich/në vetën e parë, Er/në vetën e tretë, narratori i besueshëm i pabesueshëm)
- të dallojë dhe të kuptojë karakteristikat e këngës epike dhe epit (dhjetërrokëshin, heksametrin, mjetet e caktuara shprehëse
- të dallojë elementet e tekstit dramatik si gjini letrare mimetike: personazhet dramatike (fytyrat ose karakteret), protagonistin dhe antagonistin, veprimin, konfliktin, hapësirën
- të vërej kompozicionin e dramës të cilin e përbëjnë: situatat dramatike, pamjet ose skenat, fotografitë dhe aktet
- të dallojë dramën si një tekst letrar (drama për lexim) dhe dramën si tekst të skenës
- të njohë elementet e gjuhës skenike: zhvillimin e dramës, hapësirën e teatrit, dekorin (shuma e shenjave vizuale), zërin (shuma e shenjave auditive), ndriçimin (kontrastin e dritës dhe hijes, ngjyrat në skenë), lëvizjen (aktorin si bartës të lëvizjes)
- të dallojë pesë fazat e zhvillimit të ngjarjes së dramës: ekspozicionin, thurjen (konfliktin), kulminacionin, kthesën (peripecinë) dhe shthurjen
- të dallojë tre unitete të dramës: veprimin, kohën dhe vendin
- të vërej veprimet karakterizuese të personazheve të dramave
- të dallojë format e të folurit në tekstin e dramës: didaskalitë/remarket, monologun, dialogun
- të dallojë karakteristikat e dramës antike
- të dallojë veçoritë e dramës moderne
- të njohë poetikën e antidramës.



## B) KANË TË BËJNË ME PJESËN II TË PROVIMIT

*Nxënësi duhet të:*

- të respektojë udhëzimet për shkrimin e tekstit dhe parimet e formulimit
- të ketë kujdes për kuptimin, lidhshmërinë dhe rrumbullakimin e tekstit
- të dallojë dhe të zbatojë stile të ndryshme funksionale në të shkruar
- të përdor forma të ndryshme të të shprehurit (narracionin, përshkrimin, refleksionin, shqyrtimin, dialogun, monologun...)
- të respektojë normën gramatikore dhe drejtshkrimore

## 5.3. TË SHPREHURIT ME SHKRIM

### SHKRIMI I TEKSTIT FUNKSIONAL

#### **NXËNËSI DUHET TË DIJË TË SHKRUAJ TEKSTIN E LLOJIT SI NË VAZHDIM:**

fletëfalënderimin , lutjen, ankesën, letrën zyrtare/jozyrtare, urimin, shpalljen, raportin, lajmin, intervistën, reportazhin, CV-në, e-mailin, paraqitjen, fletëparaqitjen për konkurs, procesverbalin...

### SHKRIMI I ESESË

#### **NXËNËSI DUHET QË:**

- i pavarur të shkruaj ese (tekst të strukturuar që ka – hyrjen, zhvillimin, përfundimin, paragrafët) dhe mendimet e veta t'i mbështesë me argumente
- duke shfrytëzuar njohuritë nga teoria e letërsisë të shpreh kuptimin e vet për tekstet e lexuara letrare
- të zbatojë normën drejtshkrimore dhe gramatikore

## 5.4. VEPRAT LETRARE TË DETYRUESHME

### LIRIKA

1. F. Petrarka: Kanconieri (sipas zgjedhjes)
2. Epi i Gilgameshit
3. L. Poradeci: Vdekja e Nositit
4. Sh. Bodëleri: Albatrosi
5. A. Podrimja: Drejtpeshimi
6. Mjeda: Liria
7. N. Frashëri: Bagëti e bujqësia

### EPIKA DHE LLOJET EPIKO-LIRIKE

1. M. Barleti: Historia e Skënderbeut
2. Gj. Fishta: Lahuta e Malcisë
3. Homeri: Iliada (VI dhe XVIII)
4. Honore de Balzak: Xha Gorio
5. I. Kadare: Gjenerali i ushtrisë së vdekur
6. F. Konica: Dr. Gjilpëra
7. Dante: Ferri
8. F. Kongoli: Ëndrra e Damokleut
9. P. P. Njegoshi: Kurora e maleve
10. Gëte: Vuajtjet e Verterit të ri
11. D. Agolli: Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo
12. A. Kamy: I huaji
13. G. Floberi: Zonja Bovari
14. Servantesi: Don Kishoti
15. Ernest Koliqi: Shija e bukës së mbrume
16. De Rada: Këngët e Milosaos
17. Pushkini: Eugjen Onjegini

### DRAMA

1. Sofokliu: Antigona
2. V. Shekspiri: Hamleti
3. A. Pashku: Sinkopa
4. S. Beketi: Duke pritur Godonë
5. Çajupi: Pas vdekjes

*Vërejtje: Në test mund të gjenden edhe detyra të cilat kanë të bëjnë me vepra të parapara me programet e lëndës.*

LEXO TEKSTIN DHE ZHVILLO  
DETYRAT 1, 2, 3, 4 DHE 5.

## HOLOGRAMET

E mbani mend Dr. Markun nga Shtigjet e Yjeve? Për nga asgjë nuk ishte i veçantë, përveç se në thelb ishte një hologram. Deri më tani hologramet i kemi takuar vetëm në formën e tyre statike, p.sh. si ato figurat e argjendta të një zogu nga kartat e kreditit të cilat na shërbejnë si provë e origjinalitetit, por e ardhmja duket se do të sjellë aplikime të reja të kësaj teknologjie.



Korporata Teknike Denko nga Kalifornia së fundit ka dalë në opinion me një prototip të polimerit fotorefraktiv, bashkim i cili do të duhej të mundësojë hologramet lëvizëse 3D. Hologrami lëvizës 3D funksionon si një varg pamjesh të cilat, kur shpërndahen me kujdes, japin iluzionin e lëvizjes që është i dukshëm edhe nga vetë syri. Përparësia e një polimerit fotorefraktues është se të dhënat (pamjet) në te mund të xhirohen, pastaj të fshihen përsëri, dhe funksionon në mënyrë të ngjashme me atë me të cilën sot “i djegim” të dhënat në CD ose DVD.

Një ditë, besojnë ekspertët, hologramet e këtilla do të bëhen “mjete ndihmëse” të përditshme në arkitekturë, mjekësi, biologji dhe shumë fusha të tjera. Është shumë më e lehtë që diçka të paramendohet dhe të shihet nëse kemi mundësi që atë ta shikojmë në 3D, dhe madje edhe në drejtim të formës lëvizëse. Ky polimer është i përbërë nga dy lloje të kopolimerëve - një është fotosensitiv dhe thith e thyen dritën në një kënd të caktuar në mënyrë që pamja të shihet, dhe pjesa tjetër është një plastifikues që përdoret për të arritur forcën dhe elasticitetin. Polimeri ishte shkruar midis dy shtresave të qelqit të deoksiduar prej 100 mm. Në një polimer të tillë imazhet xhirohen me lazer jeshil me gjatësi valore 532 nanometra. Imazhet mund të ndërrohen çdo 30 milisekonda, duke i dhënë syrit të njeriut përshtypjen e një imazhi 3D në lëvizje.

Megjithatë, kjo nuk është një detyrë aspak e lehtë, pasi që për xhirimin e një pamjeje 3D në polimer duhen rreth dy minutave, ndërkohë që nevojiten shumë pamje 3D që të fitohet një hologram në lëvizje. Duhet të gjendet një mënyrë për të përshpejtuar gjithë këtë proces, dhe që koha në të cilën ndërrohen dy pamje të jetë sa më e shkurtër në mënyrë që hologrami 3D të duket mirë kur të zmadhohet.

Përkushtimi i shkencëtarëve të cilët punojnë në këtë projekt së shpejti duhet të mundësojë p.sh. ekzaminimin mjekësor të eshtrave para operacionit, ose shikimin e skicave 3D të një vendbanimi të planifikuar banesor për arkitektët, kurse të dashuruarve tjerë në holograme ndoshta të shohin Dr Markun ose Princeshën Lejën.

Burimi: <http://znanost.geek.hr/clanak/hologrami-nasa-buducnost/#ixzz43eliN7ZT>

**1.** Cili është ndryshimi themelor midis prototipave të dikurshëm dhe një prototipi të ri të hologramit?

.....  
1 pikë

**2.** Çfarë e bën figurën të dukshme në këtë prototip?

.....  
1 pikë

**3.** Një pjesë e polimerit duhet të jetë:

1. Plastik dhe elastik
2. Metalik dhe i ngurtë
3. Prej drurit dhe elastik
4. Gjysmëmetal dhe elastik

*RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË DHE ZGJIDHJEN BARTE NË FLETËN E PËRGJIGJEVE.*

1 pikë

**4.** Argumento ku qëndron problemi më i madh për fitimin e një hologrami në lëvizje?

.....  
1 pikë

**5.** Argumento se si hologramet e tilla do të mund të jenë të dobishme për mjekun lidhur me pamjet e radiografisë?

.....  
2 pikë

## LEXON FRAGMENTIN, PASTAJ ZHVILLO DETYRAT 6, 7, 8 DHE 9.

Ai bëri një përmbledhje të fakteve duke filluar nga vdekja e mamasë. Përmendi pandjeshmërinë time dhe se nuk dija ç'moshë kishte mamaja ime, larjen në det të nesërmen e varrimit të saj, me një femër, kinemanë, Fernandelin dhe në fund kthimin të shtëpia ime së bashku me Marinë. Unë nuk e kuptova që në fillim se ishte fjala për të, sepse ai thoshte “dashnoria e tij”, kur për mua ajo ishte Maria. Më pas kaloi te historia e Rajmondit. Vura re se mënyrës si i shihte ngjarjet nuk i mungonte qartësia. Ajo që thoshte ishte e mundur. Kisha shkruar letrën duke u marrë vesh me Rajmondin për të future në kurth të dashurën e tij, ku e priste një zhdëpje në dru nga një njeri me “moral të dyshimtë”. Unë i kisha ngacmuar në plazh kundërshtarët e Rajmondit. Ky i fundit u plagos. Unë i kërkova revolverin e tij. Isha kthyer vetëm për të vrarë arabin, ashtu siç e kisha bërë me mendje. Dhe kisha pritur. Dhe “për t’u siguruar se puna ishte kryer mirë”, kisha qëlluar përsëri katër herë mbi trupin e shtrirë për tokë – qetësisht, pa m’u dridhur dora dhe, si të thuash të menduar mirë e bukur.

-Dhe ja, zotërinj, - tha prokurori, - unë parashtrova para jush fillin e ngjarjeve që e çuan këtë njeri të vrasë me ndërgjegje të plotë.

### 6. Shkruaje titullin e veprës, emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.

1 pikë

### 7. Kush është rrëfyesi në këtë fragment?

1. rrëfimtari i gjithëdëshëm
2. prokurori publik
3. Mersoja

RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË DHE ZGJIDHJEN BARTE NË FLETËN E PËRGJIGJEVE.

1 pikë

### 8. Pikëpamja e kujt jepet në këtë fragment e thënë me fjalinë:

Dhe “për t’u siguruar se puna ishte kryer mirë”, kisha qëlluar përsëri katër herë mbi trupin e shtrirë për tokë – qetësisht, pa m’u dridhur dora dhe, si të thuash të menduar mirë e bukur.

1 pikë

**9.** Rretho numrin pranë cilësisë që mund t'i atribuohet heroit të kësaj vepre dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. arroganca
2. guximi
3. vendosmëria
4. tjetërsimi

1 pikë

**10.** Lexo fragmentin nga drama Antigona dhe puno detyrën.

ANTIGONA

*Nuk po të vihem, dhe në daç më vonë  
të më japësh ndihmë, nuk do të më kënaqësh,  
bëj pra si të duket, si të të pëlqejë.  
Un' atë pa tjetër do ta kall në dhe;  
po ta bëj këtë, do vdes e nderuar.  
Do të prehem pranë atij që më do,  
atij që e dua; do të bëj një krim,  
po një krim të shenjtë; është m'e gjatë koha  
që do t'u pëlqej atyre të Hadit,  
se atyre q'janë këtu përmbi dhe,  
se atje gjithmonë do të rri e shtrirë.  
Ti, në të pëlqeftë, përbuzi ato  
q'i çmojnë dhe hyjtë.*

ISMENA

*Unë s'i përbuz, po kundër qytetit  
edhe qytetarëve nuk mund të veproj.*

Cilës etapë të zhvillimit të kompozicionit të dramës i përket fragmenti i dhënë?

1 pikë

**11.** Radhiti shkrimtarët e mëposhtëm sipas kronologjisë së paraqitjes së tyre në letërsi:

Jeronim de Rada

Ulliam Shekspir

Ndre Mjeda

Samuel Beket

Aleksandër Pushkin

1 pikë

## LEXO FRAGMENTIN NGA *KURORA E MALEVE* (P. P. NJEGOSH) DHE PËRGJIGJU NË PYETJET 12, 13 DHE 14.

*I ri po je, vlladikë, pa përvoj'!  
T'parat pika nga gotë e helmit  
më të hidhtat, më ngulmueset jan':  
oh ta dijsht ti, se ç'të pret akoma!  
Është tiran kjo botë për tiranin,  
lëre pastaj për atë shpirtmirin!  
Ajo është mospajtim i tmerrshëm:  
në të lufton shpirti kundër trupit,  
në të lufton ndaj brigjeve deti,  
në të lufton të ftohtit e të nxehtit,  
në të luftojn' erërat me erëra,  
në të lufton me t'gjallët i gjalli,  
në të lufton populli me popull,  
në të lufton me njeriun njeriu,  
në të luftojn' ditët kundër netëve,  
në të luftojn' shpirtërat me qiejt'.*

### 12. Cili personazh i thotë këto fjalë?

1 pikë



**13.** Cilat figura stilistike përdoren në vargjet në vazhdim:

...në të lufton shpirti kundër trupit,  
në të lufton ndaj brigjeve deti,  
në të lufton të ftohtit e të nxehtit,

.....  
.....

2 pikë

**14.** A) Rretho numrin para dy personazheve të cilët nuk bëjnë pjesë në veprën *Kurora e maleve*.

1. Demka
2. Igumen Stefani
3. Vurku
4. Vlladikë Danilloja
5. Vuk Mandushiqi

1 pikë

**B) Argumentoje përgjigjen.**

.....  
.....  
.....  
.....

2 pikë

**15.** Vetëm njëra nga karakteristikat ka të bëjë me karakterin e Emës tek vepra "Zonja Bovari" të Gustav Floberit, veçoje atë dhe argumentoje përgjigjen:

bie viktimë e pasioneve      ka mendime moderne      është një vajzë qytetare

.....  
.....

2 pikë

**16.** Lexoje fragmentin nga romani Xha Gorio (Honore de Balzak) dhe zhvillo detyrën.

*Ah, po të isha i pasur, po ta kisha ruajtur pasurinë time e të mos ua kisha dhënë, ato do të ishin këtu, do të më lanin faqet me të puthura! Do të banoja në një pallat, do të kisha dhoma të bukura, shërbëtorë, zjarr për t'u ngrohur dhe ato do të ishin këtu, me lot nëpër faqe, me gjithë burrat dhe fëmijët e tyre. Do t'i kisha të gjitha. Kurse tani s'kam asgjë!*

**A) Karakterizimi i heroit të cilit i referohet fragmenti është:**

1. dinamike (zhvillim)
2. statike (e mbizotëruar nga një person)

*RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË.*

1 pikë

**B) Argumentoje përgjigjen.**

.....

.....

.....

1 pikë

**17.** Si quhet vepra e Aristotelit në të cilën ka paraqitur idetë e para teorike për tragjedinë dhe poezinë epike?

1. Bretkosat
2. Parathënia e Komedisë njerëzore
3. Mbi artin poetik
4. Parathënia e veprës Shteti

*RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË DHE ZGJIDHIEN BARTE NË FLETËN E PËRGJIGJEVE.*

1 pikë

**18.** Lexo tekstin dhe përgjigju në pyetje.

*“... rinia duhet të rrojë në shoqërinë shpirtërore me ata burra të ditur të botës, fama e të cilëve qëndron në mençurinë, sepse nëpërmjet këtyre dhe me ndihmën e filozofisë ajo do të ngrihet më lart nga poshtërsitë e jetës”.*

**A) Kujt i jepet më shumë rëndësi në këtë fragment?**

..... *1 pikë*

**B) Shëno emrin e lëvizjes letrare e cila e theksonte më shumë këtë.**

..... *1 pikë*

**19.** Pranë shkurtesës së saktë shëno S, kurse pranë shkurtesës së pasaktë shkruaj P. Shkurtesën e pasaktë shkruaje saktë.

bf. (bie fjala) .....

er. (era e re) .....

psh. (për shembull) .....

kg (kilogram) .....

IP (Institucioni publik) .....

e.t.j. (e të tjerë) .....

*1 pikë*

**20. Formën joveprore të foljes zëvendësoje me formën tjetër foljore.**

*Parashikohet që sulmet e tyre të ardhshme të jenë akoma më të egra...*

.....  
*1 pikë*

**21. Fjalët e më poshtme janë?**

1. universi – gjithësia .....

2. shkoj – vij .....

3. vera (stinë) – vera (pije) .....

*1 pikë*

**22. A) Rretho numrin para fjalës së shkruar gabim.**

1. sbardh
2. shthurje
3. çorganizoj

*1 pikë*

**B) Argumento përgjigjen.**

.....  
.....  
*1 pikë*

### 23. Rishkruaje tekstin duke respektuar drejtshkrimin.

*...S 'të vjen të pëlçasësh thoshte sekretari i gjyqit ta kesh thesarin përpara syve të jesh ulur kushedi sa herë mbi atë gur dhe të vijë tjetri të ta marrë Tasi ia ktheu se ai mund të mos kishte gjetur florinj po para të vjetra nga ato që ne edhe po t'i gjejmë rrugës nuk ulemi t'i ngrejmë nga toka.*

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

2 pikë

**24.** Shkruaj një **letër zyrtare** (Numër: 02-347) me të cilën Nora Gashi në emër të paraleles III2 të shkollës së mesme “Vëllazërim- bashkim” nga Ulqini, me datë 12 prill 2020 i drejtohet Këshillit drejtues të gazetës së përjavshme „Koha Javore“ që nëse është e mundur t’ia dhuroj shkollës së tyre nga një ekzemplar të të gjitha numrave të gazetës nga fillimi deri më sot, për shkak të realizimit të një projekti lidhur me botimet shqip të gazetave.

Respektoni formën e tekstit, me të gjitha të dhënat e domosdoshme që duhet t’i ketë një LETËR ZYRTARE si dhe respektoni gjuhën standarde.

8 pikë

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

**25.** Janë dhënë dy tema për shkrimin e esesë. Rretho numrin e temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë.

- Me rastin e zhvillimit të temës, shfrytëzo shembujt relevant/të dhënat dhe argumento qëndrimet personale.

- Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/- 10%

(vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM, kurse në fjalën e 330-të, NDËRPRITET leximi).

- Kij kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.

## 1. Motivet në poezinë *Liria* - N. Mjeda

### UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Shkruaj tiparet themelore të poezisë (autorin, llojin letrar dhe drejtimin).
- Paraqit se çfarë nënkupton autori me lirinë.
- Mesazhet e poezisë drejtuar shqiptarëve, bazuar në lirinë amerikane.
- Me rastin e zhvillimit të temës, lidhi shembujt relevant me faktet e argumentuara dhe paraqitjen e qëndrimeve personale.

## 2. Dhuna në mes të bashkëmoshatarëve sfidë për komunitetin

### UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Trego për llojet e dhunës së bashkëmoshatarëve në rrethin tënd.
- Vlerëso çfarë pjese në dallimin dhe pengimin e dhunës së bashkëmoshatarëve kanë individi, familja dhe shkolla.
- Jepe përfundimin për dhunën në mes të bashkëmoshatarëve, si një pasqyrë të bashkësisë shoqërore duke dhënë propozime konkrete për mënyrën e parandalimit të kësaj dukurie.

13 pikë

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

## FLETA E PËRGJIGJEVE

Gjuhë shipe dhe letërsi

Udhëzimi për shënimin e përgjigjes së saktë:

**Detyra do të vlerësohet me 0 pikë:**

- nëse është shënuar përgjigja e pasaktë
- nëse janë shënuar më shumë përgjigje
- nëse nuk është shënuar asnjë përgjigje



Drejt



Gabim

Nëse gaboni, atë fushë shënojeni këbhtu:   
kurse përgjigjen e dëshnuar shënojeni sipas rregullit të paraqitur

**KËTU  
NGJITNI SHIFRËN  
E NXËNËSIT**

	1	2	3	4
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	1	2	3	4
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>



2 2 1 6 5 3 4 1 7 1 1 5 6

# ZGJIDHJA 8

## ETESTIË ME SKEMË PËR VLERËSIM

1. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Prototipi i ri i hologramit është i lëvizshëm/ Lloji i ri është 3D/ Lloji i ri është 3D lëvizës (dhe përgjigje të tjera të sakta)
2. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: E bën kopolimetri fotosensibil (i cili thith dhe thyen dritën në një kënd të caktuar) (dhe përgjigje të tjera të sakta)
3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 1 - *Plastik dhe elastik*
4. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Problemi më i madh me marrjen e një hologrami në lëvizje është koha./Për xhirimin e një pamjeje 3D në polimer duhen 2 minuta, ndërsa nevojiten shumë pamje të tilla që të fitohet hologrami i lëvizshëm/ Xhirimi i një pamjeje zgjatë shumë dhe përgjigje të ngjashme (dhe përgjigje të tjera të sakta)
5. Argumenton se një hologram në lëvizje do të tregonte p.sh. kockën nga të gjitha këndet dhe jo vetëm nga një dimension si në pamjet e radiografisë/ do të ishte sikur të shikosh kockat në realitet/ mund të krahasosh pjesët e sëmura dhe të shëndetshme të kockave dhe përgjigje të ngjashme – **2 pikë**  
Hologrami jep më shumë informacione sesa pamjet e radiografisë dhe përgjigje të ngjashme – **1 pikë**  
Nuk pranohet përgjigjja: i ndihmon mjekut që t'i analizojë kockat para operacionit (që nuk është një interpretim i të dhënave, por thjesht një citim nga teksti)
6. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: I huaji, Alber Kamy
7. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 3 - *Mersoja*
8. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Pikëpamja e prokurorit publik/ prokurorit publik/ prokurori publik*

9. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 4 - tjetërsimi
10. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *ekspozicionit/ hyrjes*
11. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar përgjigje plotësisht të saktë: Shekspiri, Pushkini, De Rada, Mjeda, Beketi
12. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Iguman Stefani
13. Gjithsej **2 pikë**:
- Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë: anafora dhe kontrasti/ antiteza.
- Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar saktë njëren figurë stilistike.
14. Gjithsej **3 pikë**:
- A) Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë: është rrethuar numri 1 – Demka dhe 3 – Vurku
- B) Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shpjeguar: Demka është personazh nga vepra Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo e Dritëro Agollit, ndërsa Vurku nga vepra Pas vdekjes e autorit Çajupi.
- Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka argumentuar saktë përgjigjen që ka të bëjë vetëm me Demkën ose vetëm me Vurkun.
15. Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka zgjedhur **bie viktimë e pasioneve** dhe zgjedhjen e vet e argumenton me të dhënat nga teksti lidhur me personazhin (Ema Bovari është një vajzë provinciale që lexon shumë libra romantikë dhe ka marrë një formim konservator në manastir. Për shkak të letërsisë romantike që lexonte, Ema bën zgjedhjet e gabuara në jetë, humbet lidhjet me realitetin dhe shndërrohet në një viktimë të pasioneve të saj, të cilat e orientojnë drejt aventurave të pafundme) apo argumente të ngjashme.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka theksuar vetëm një argument, që ka të bëjë me personazhin ose nëse përgjigja është e saktë, por ka gabime gjuhësore apo stilistike.

**16.** Gjithsej **2 pikë**:

- A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 1 – *dinamike (zhvillim)*
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Heroi në fillim ishte një djalë i thjeshtë nga provinca, kurse më vonë i ndikuar nga rrethi vendos të hyjë në rrethin shoqëror të të pasurve/ ndryshon duke u ndikuar nga shoqëria/ nuk është i kënaqur me statusin në shoqëri/ dëshiron të pasurohet prandaj ndryshon dhe karakter e të tjera përgjigje që çojnë deri tek personazhi në zhvillim.

**17.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 3 – *Mbi artin poetik*

**18.** Gjithsej **2 pikë**:

- A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: arsimit/ mësimi/ Librit dhe përgjigje të tjera të cilat kanë të bëjnë me arsimimin
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: iluminizmi

**19.** Nxënësi merr **1 pikë** për pesë apo gjashtë përgjigje të sakta:

bf. (bie fjala)	P; b.f.
er. (era e re)	P; e.r.
psh. (për shembull)	P; p.sh.
kg (kilogram)	S
IP (Institucioni publik)	S
e.t.j. (e të tjerë)	P; etj.

Nxënësi merr **0 pikë** për katër apo më pak përgjigje të sakta.

**20.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Parashikonte që sulmet e tyre të ardhshme të jenë akoma më të egra...

21. Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

1. sinonime
2. antonime
3. homonime

22. Gjithsej **2 pikë**:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 1 - sbardh

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: shkruhet me z- zbardh, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme

23. Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë, përkatësisht ka shënuar saktë të gjitha presjet dhe thonjëzat:

“S’ të vjen të pëlcasësh,” thoshte sekretari i gjyqit, “ta kesh thesarin përpara syve, të jesh ulur kushedi sa herë mbi atë gur dhe të vijë tjetri të ta marrë?  
“ Tasi ia ktheu se ai mund të mos kishte gjetur florinj, po para të vjetra, nga ato që ne edhe po t’i gjejmë rrugës, nuk ulemi t’i ngrejme nga toka.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka bërë vetëm një gabim (p.sh. ka shënuar gabim ose nuk ka shënuar fare një presje ose një thonjëz.

Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka dy ose më shumë gabime.

## 24. Skema e vlerësimit të tekstit funksional

FORMA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT 3 pikë	GJUHA 3 pikë	STILI 2 pikë
<p>Të gjithë të dhënat të shkruara në udhëzim janë renditur sipas parimeve të hartimit të tekstit. <i>3 pikë</i></p> <p>Të gjitha të dhënat janë renditur mirë, por mungon ndonjë e dhënë që e vështirëson kuptimin e tekstit, përkatësisht elementi kryesor që nuk e përmbys formën e tekstit. <i>2 pikë</i></p> <p>Mungojnë shumë të dhëna, por teksti kuptohet. <i>1 pikë</i></p> <p>Nuk është respektuar forma e dhënë ose përmbajtja e tekstit është e pakuptueshme. <i>0 pikë</i></p>	<p>Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. <i>3 pikë</i></p> <p>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore pjesërisht është respektuar, por ka lëshime si: - përdorimi i shenjave të pikësimit - përdorimi i drejtë i pjesëve gramatikore. <i>2 pikë</i></p> <p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht; - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore - gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura <b>dhe/ apo</b> - gabon në përdorimin e parafjalëve... <i>1 pikë</i></p> <p>Në tekst ekzistojnë tre apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j, gabon në përdorimin e trajtës mohuese. <i>0 pikë</i></p>	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. <i>2 pikë</i></p> <p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ i drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. <i>1 pikë</i></p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... <i>0 pikë</i></p>

## 25. Skema e vlerësimit të esesë

### Motivet në poezinë *Liria* – N. Mjeda

*Përmbajtja* – 7 pikë

Respektimi i kërkesave të dhëna	Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna: - cekja e saktë e autorit, llojit letrar dhe drejtimit (1 pikë) - kuptimi i lirisë sipas autorit (1 pikë) - liria e popullit amerikan dhe atij shqiptar (1 pikë) <i>Gjithsej 3 pikë</i>
Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit, idesë...	Krijimi i tekstit: - qasja origjinale/ kreative ndaj temës (1 pikë) - përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës / të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi me fakte dhe qëndrime personale (1 pikë) <i>Gjithsej 4 pikë</i>



**Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë**

<p>GJUHA 3 pikë</p>	<p>STILI 2 pikë</p>	<p>FORMA GRAFIKE E TEKSTIT 1 pikë</p>
<p>Në tekst nuk ka gabime drejtshkrimore dhe gramatikore. <i>3 pikë</i></p> <p>Norma gramatikore dhe drejtshkrimore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore.</li> </ul> <p><i>2 pikë</i></p> <p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore</li> <li>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura <b>dhe/ apo</b>)</li> <li>- gabon në përdorimin e parafjalëve...</li> </ul> <p><i>1 pikë</i></p> <p>Në tekst ekzistojnë tre apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.</p> <p><i>0 pikë</i></p>	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. <i>2 pikë</i></p> <p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ i drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. <i>1 pikë</i></p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... <i>0 pikë</i></p>	<p>Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). <i>1 pikë</i></p> <p>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). <i>0 pikë</i></p>

## Skema e vlerësimit të esesë:

*Dhuna në mes të bashkëmoshatarëve sfidë për komunitetin*

*Përmbajtja – 7 pikë*

<p>Respektimi i kërkesave të dhëna</p>	<p>Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- cekja e formave të dhunës në mes të bashkëmoshatarëve (1 pikë)</li><li>- roli i individit, familjes dhe shkollës në parandalimin e dhunës në mes të bashkëmoshatarëve (1 pikë)</li><li>- propozimi/ propozimet për parandalimin e dhunës në mes të bashkëmoshatarëve (1 pikë)</li></ul> <p><i>Gjithsej 3 pikë</i></p>
<p>Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit, idesë...</p>	<p>Krijimi i tekstit:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- qasja origjinale/ kreative ndaj temës (1 pikë)</li><li>- përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë)</li><li>- argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë)</li><li>- argumentimi me fakte dhe qëndrime personale (1 pikë)</li></ul> <p><i>Gjithsej 4 pikë</i></p>



*Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë*

<p>GJUHA 3 pikë</p>	<p>STILI 2 pikë</p>	<p>FORMA GRAFIKE E TEKSTIT 1 pikë</p>
<p>Në tekst nuk ka gabime drejtshkrimore dhe gramatikore. <i>3 pikë</i></p> <p>Norma gramatikore dhe drejtshkrimore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore.</li> </ul> <p><i>2 pikë</i></p> <p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore</li> <li>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura <b>dhe/ apo</b></li> <li>- gabon në përdorimin e parafjalëve...</li> </ul> <p><i>1 pikë</i></p> <p>Në tekst ekzistojnë tre apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.</p> <p><i>0 pikë</i></p>	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. <i>2 pikë</i></p> <p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ i drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave.</p> <p><i>1 pikë</i></p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara...</p> <p><i>0 pikë</i></p>	<p>Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). <i>1 pikë</i></p> <p>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). <i>0 pikë</i></p>

**SHËNIM:**  
Nëse nxënësi nuk merr pikë ose në përmbajtje ose në gjuhë eseja në tërësi do të vlerësohet me zero (0) pikë, si dhe punimi shumë i parregullt dhe i palexueshëm ose punimi me shembuj të papërshtatshëm leksikor, përkatësisht eseja e cila NUK është e shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në fletat e konceptit.

Tekstet shkollore të cilat i ka aprovuar Këshilli Nacional i Arsimit dhe Ministria e Arsimit të Malit të Zi për përdorim në gjimnazin e përgjithshëm dhe në shkollat e mesme profesionale.



# 9

## LITERATURA ■

[www.iccg.co.me](http://www.iccg.co.me)

